

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i krimeve të rënda, kolegji i përberë nga gjyqtarët Driton Muharremi, kryetar, Mejreme Memaj e Shqipe Qerimi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve **A.H.**, nga Mitrovica..., **S.F.**, nga Mitrovica, për shkak të veprës penale intoksimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotropike, parashikuar me nenin 276 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në vazhdimësi, parashikuar me nenin 229 par.2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), **G.M.**, nga Mitrovica, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike dhe analoge, parashikuar me nenin 229 par.2 të KPRK, **M.K.**, nga fshati... i Mitrovicës, për veprën penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike dhe analoge në vazhdimësi, parashikuar me nenin 273 par.2 lidhur me par.1 e nenin 81 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurores së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ato të mbrojtësve të të pandehurve avokateve K.B., Xh.H., B.M. e A.L., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.482/2013 datë 18.10.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale(KPP), me 27 Maj 2014, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës së Prokurorit Themelor në Mitrovicë, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.482/2013 datë 18.10.2013, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit ndryshohet ashtu që kjo Gjykatë të akuzuarit A.H. e S.F. konform dispozitës së nenit 365 të KPP i shpall fajtor

“ sepse në fillim të muajit shtator të vitit 2012 në restorantin e quajtur “NNT”, në Mitrovicë ne bashkëkryerje kanë intoksikuar me narkotikë të miturin G.R. pa dijen e tij në atë mënyrë që deri sa ishin duke pi kafe të akuzuarit S.F. e A.H. se bashku me të dëmtuarin të miturin G.R. ku ishte prezent edhe personi i quajtur V.S., i akuzuari S.F. me një paketim të cigares të quajtur “Lucky Strike”, ku në të kishte substancë narkotike-marihuanë të mbështjellë ne formë të cigares e që këtë e kanë përgatitur se bashku me të akuzuarin A.H. i ofrojnë marihuanën e mbështjellë në formë të cigares “Joint” të dëmtuarit G.R. dhe këtë cigare ia ofrojnë në mënyrën të cilën e mbanin në paketim të cigares të quajtur “Lucky”, me ç’rast i dëmtuari G.R. e merr duke menduar se është cigare dhe pa dije e përdor këtë

substancë narkotike duke mos ditur se është marihuan, e pastaj të akuzuarit A.H. dhe S.F. se bashku me të dëmtuarin G.R. dalin nga lokali dhe duke i propozuar të dëmtuarit G.R. të shkojnë tek parku afër lumit "Ibër", ku edhe njëherë që të tretë e marrin edhe nga një cigare e cila ka qenë e mbështjellë me marihuan e që pasi që G.R., i dëmtuari e merr edhe një herë marihuanen të akuzuarit i tregojnë se ketë cigare që e ke pira është drogë duke e kushtëzuar që prej tash do të besh çka te themi ne, se do t'i tregojmë vëllait të tij E.R. i cili do t'i tregon babait të tij.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale intoksimi i personit tjetër me narkotik ose substancë psikotropike, parashikuar me nenin 276 lidhur me nenin 31 të KPRK,

Gjykata konform dispozitave ligjore i gjykon secilin me nga 1 (një) vit burgim, në të cilin dënim do tu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak dhe atë të akuzuarit A.H. koha e kaluar në paraburgim prej 19.02.2013 deri me 19.03.2013 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 19.03.2013 deri me 3.07.2013, kurse të akuzuarit S.F. koha e kaluar në paraburgim prej 19.02.2013 deri me 19.03.2013, prej 11.04.2013 deri me 18.10.2013, dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 19.03.2013 deri me 11.04.2013.

II. Me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve A.H. e S.F. aktgjykimi i lartcekur në pjesën gjyquese nën pikën II tëdispozitivit të aktgjykimit ndryshohet ashtu që këta të akuzuar konform dispozitës së neni 364 par.1 pika 1.1 të KPP lirohen nga akuza sepse:

1) Në muajin shtator të vitit 2012 në afërsi të objektit ku gjendet TMK në Mitrovicë pa autorizim janë furnizuar me substanca narkotike, pastaj në bashkëkryerje kanë shpernda te i dëmtuari-i mituri G.R. në atë mënyrë që në fillim pasi takohen me të dëmtuarin G.R. afër restorantit "NN2", nga i cili marrin 5€ e gjysmë, shkojnë në afërsi të objektit të TMK në Mitrovicë ku i akuzuari S.F. shkon për të blerë një qesë me substancë narkotike marihuan nga i akuzuari M.K. i cili kur kthehet pas një kohe të shkurtër se bashku me të akuzuarin A.H. mbështjellin tri cigare me marihuan njërin ia japin të dëmtuarit G.R., ndërsa, dy i marrin nga një për vete.

2) po ashtu ka mesazh i muajit shtator të vitit 2012 të akuzuarit S.F. dhe A.H. nga i dëmtuari G.R. kanë marrë të holla me vlerë prej 1€ e 50cent dhe i akuzuari S.F. me këto para, nga i akuzuari M.K. ka blerë substancë narkotike me të cilat ka mbështjellë një cigare Join të cilën e kanë konsumuar të dy të akuzuarit të cilën e shpërndajnë për ta konsumuar edhe tek i dëmtuari G.R. dhe këtë e konsumojnë në afërsi të restorantit "NN2".

-me çka kishin për të kryer veprën penale në vazhdim blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshme dhe substancave psikotropike, nga neni 229 par.2 të KPK.

III. Me aprovimin e pjesëshëm të ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve G.M. e M.K. aktgjykimi i lartcekur përkitazi me këta të akuzuar ndryshohet vetëm sa i përket vendimit për dënim me burgim, ashtu që kjo Gjykatë të akuzuarin G.M. për veprën penale nga neni 229 par.2 të KPK për të cilën është shpall fajtor e gjykon me 1(një) vit burgim në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 19.02.2013 deri me

03.07.2013, kurse të akuzuarin M.K. për veprën penale nga neni 273 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 81 të KPRK, për të cilën është shpall fajtor e gjykon me 2(dy) vite burgim, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 20.02.2013 deri me 26.06.2013. Dënimet e shqiptuara me gjobë në shume prej nga 300€, u merren si të vërtetuara.

**IV.** Aktgjykimi i lartcekur përkitazi me të akuzuarit A.H. e S.F. në pjesën liruese përkitazi me veprën penale nga neni 229 par.2 lidhur me nenin 26 të KPK ngel i pashqyrtuar.

## A r s y e t i m i

Me aktakuzën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PPI.nr.19/2013 datë 14.03.2013, të akuzuarit A.H. e S.F. janë akuzuar për veprën penale Intoksimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotropike, parashikuar me nenin 276 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në vazhdim, parashikuar me nenin 273 par.2 lidhur me nenin 31, 32 e 81 të KPRK; i akuzuari G.M. për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike dhe analoge, parashikuar me nenin 273 par.2 të KPRK; kurse i akuzuari M.K. për veprën penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike dhe analoge, parashikuar me nenin 273 par.2 lidhur me par.1 e nenin 81 të KPRK.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.482/2013 datë 18 tetor 2013 të akuzuarit A.H. e S.F. konform dispozitës së nenit 364 par.1 nënpar.1.1 të KPP i liron nga akuza për veprat penale Intoksimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotropike, parashikuar me nenin 276 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, parashikuar me nenin 229 par.2 lidhur me nenin 26 të KPK, ndërsa i shpall fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike dhe analoge në vazhdim, parashikuar me nenin 229 par.2 të KPK, të akuzuarin G.M. e shpall fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, nga neni 229 par.2 të KPK, M.K. për veprën penale posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike dhe analoge, parashikuar me nenin 273 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 81 të KPRK, dhe i gjykon të akuzuarit A.H., S.F. e G.M. me dënim burgu në kohëzgjatje prej nga 1(një) vit e 6(gjashtë) muaj, dhe dënime me gjobë në shumë prej nga 300€. Në dënimet me burg u është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak dhe atë të akuzuarve A.H. e G.M. koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 19.02.2013 deri me 03.07.2013, të akuzuarit S.F. koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 19.02.2013 deri me 18.10.2013. I akuzuari M.K. është gjykuar me 2(dy) vite e

6(gjashtë) muaj burgim dhe dënim me gjobë në shume prej 300€, në dënimin me burg i është llogarit edhe koha e kaluar në paraburgim prej 20.02.2013 deri me 26.06.2013. Në rast së të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë në afatin prej dy muajve pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit i njëjti do tu shndërrohet në dënim me burg duke ua llogaritur një dite të kaluar në burg nga 15€ të gjobës. Janë obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë nga 50€. Të akuzuarit M.K. në kuptim të dispozitës së nenit 273 par.5 të KPRK i është konfiskuar substanca narkotike kanabis-marihuan me peshë të përgjithshme prej 53.72 gr si dhe një blurëse i cili është përdor për bluarjen e marihuanës.

Kundër këtij aktgjykimi përpjesën gjykuese ankesa kanë ushtruar:

- Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, vetëm për pjesën liruese për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim(kështu theksohet në ankesë), me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i kundërshtuar në pjesën liruese të ndryshohet;

- Mbrojtësi i të akuzuarit S.F., avokati A.L., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim;

- Mbrojtësi i të akuzuarit A.H. avokati Xh.H., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza në mungesë të provave;

- Mbrojtësi i të akuzuarit G.M., avokati B.M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim ose të ndryshohet ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza;

- Mbrojtësi i të akuzuarit M.K., avokati K.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza apo t'i shqiptohet dënim me i butë apo të anulohet dhe çështja t'i kthehet shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPP për të cilën i njoftoj palët. Në seancë prezantuan Prokurori i Apelit Xhevdet Bislimi, të akuzuarit M.K. me mbrojtësin tij avokatin K.B., i akuzuari S.F., i akuzuari G.M. me mbrojtësin e tij avokatin B.M. dhe mbrojtësi i të akuzuarit A.H. avokati Xh.H., kurse i akuzuari A.H. dhe mbrojtësi i të akuzuarit S.F. avokati A.L. dhe i dëmtuari G.R. edhe pse të njoftuar me rregull nuk morën pjesë në seancë. Prokurori i Apelit e mbështeti propozimin e bërë me shkrim PPA/I.nr. 447/2013 datë 5.12.2013, me të cilin ka propozuar që ankesa e Prokurorit të miratohet, aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet në pjesën liruese ashtu që të akuzuarit A.H. e S.F. të shpallen fajtor për veprën penale Intoksimi i personit tjetër me

narkotik ose substanca psikotropike, nga neni 276 lidhur me nenin 31 të KPK dhe të njëjtin të gjykohen sipas ligjit ose çështja në këtë pjesë të anulohet dhe të kthehet në rigjykim, kurse ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve A.H., S.F., G.M. e M.K. të refuzohen si të pabazuara. Mbrojtësit e pranishëm pasi që sqaruan disa nga pretendimet nga ankesat mbështeten propozimet e bëra në to, kurse të akuzuarit mbështeten pretendimet e mbrojtësve të tyre.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e kësaj çështje penalo-juridike, e studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, konstatoi se:

- Ankesa e Prokurorit për pjesën liruese dhe ajo e mbrojtësve të të akuzuarve A.H. e S.F. në pjesën gjyquese përkitazi me këta të akuzuar janë të bazuara, kurse ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve G.M. e M.K. janë të bazuara vetëm sa i përket vendimit për dënim.

### **I. Vlerësimet e kësaj Gjykate përkitazi me pjesën liruese të aktgjyimit të shkallës së parë.**

Në ankesën e Prokurorit sa i përket pjesës liruese të aktgjyimit pretendohet se aktgjykimi në këtë pjesë është i përfshire me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 pika 1.12, ngase aktgjykimi nuk është përpiluar konform dispozitës së nenit 370 pika 7 të KPP, kurse në arsyetim nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare. Se ku qëndrojnë këto shkelje Prokurori nuk jep arsye, por, në këtë drejtim i referohet gjendjes faktike dhe aplikimit të ligjit penal. Kështu, sipas ankesës gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar deklaratën e të dëmtuarit G.R. nga e cila vërtetohet se në veprimet e të pandehurve qëndrojnë elementet e veprës penale Intoksimi i personit tjetër me narkotike ose substanca narkotike ose substanca psikotrope, nga neni 276 lidhur me nenin 31 të KPRK, por i liron të akuzuarit nga kjo vepër me arsyetimin se vepra penale është kryer në vitin 2012 kur ka qenë në fuqi Kodi Penal i cili nuk e ka paraparë një vepër të tillë penale. Sipas ankesës Gjykata e ka shkel ligjin penal në favor të të pandehurve ngase Kodi Penal i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale e parashihet këtë vepër konkretisht neni 229 par.4 pika 6 e 9 të KPK. Sipas Prokurorit meqë Kodi Penal i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar të vitit 2013 ishte me i favorshëm ngase parasheh një dënim me të butë me burgim prej 1 -5 vite burgim për dallim prej Kodit të vjetër i cili për këtë vepër ka paraparë dënimin prej 3 deri në 15 vite burgim vepra penale është cilësuar sipas Kodit të ri Penal.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e Prokurorit për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk janë të bazuara, mirëpo, përkitazi me gjendjen e fakteve dhe shkeljes së ligjit penal janë të bazuara. Në këtë çështje penalo-juridike përkitazi me këtë vepër penale gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe plotësisht, mirëpo në kuadër të gjendjes faktike drejt të vërtetuar gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar ligjin penal kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza, me arsyetim se në rastin konkret vepra penale nuk është paraparë me ligjin penal i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Kështu, i dëmtuari G.R. në dëshminë e tij ka dëshmuar se në muajin shtator të vitit 2012 me të akuzuarit A.H. dhe S.F. është njoftuar përmes V.S.. Së bashku me V.S. kanë shkuar në kafiqin "NNt" ku i akuzuari S.F. i ka ofruar një cigare nga pakoja "Lucky Strike", pasi që e ka përdorur atë cigare e ka ndier veten të trulluar. Kur kanë dalë nga lokali V.S. ka shkuar në shtëpi, kurse ai së bashku me A.H. dhe S.F. kanë shkuar tek parku, ku ia kanë dhënë edhe një cigare të cilën e ka dëzë, dhe derisa ka përdorur cigare e kanë incizuar përmes telefonit atë dhe vetën. Pas incizimit i kanë treguar se cigarja që ka përdorur është drogë dhe tash e tutje nëse nuk bën çka t'i thonë ata do ti tregojnë vëllait të tij E.R. e i cili do ti tregojnë babait të tij. Pas një jave është takuar me ta tek kazinoja afër restorantit "NN2", i kanë thënë shko në shtëpi boni 5 € e gjysmë për me ble qasi cigare. Ka shkuar në shtëpi ka marrë parat dhe ua ka dhënë. S.F. ka ble bari qysh i thoshin. Pasi që ka ardhur S.F. barin e gjelbër e ka mbështjell në formë të dy cigareve, të cilat i kanë dëzë dhe pastaj herë njeri e herë tjetri ia kanë dhënë me e pi. Në takimin e radhës ata ia kanë shti duart në xhepa, ia kanë marrë 1€ e 50cent, me të cilat S.F. ka ble bari të cilën e ka mbështjell me një cigare të cilën e kanë pi. S.F. i ka thënë se këtë bari e merr nga një person i quajtur M.K. me pseudonim .... Sa herë është takuar me ta e kanë detyruar me marrë parë prej shtëpisë me të cilat kanë ble qasi bari dhe atë e kanë shti me pi. Meqë nuk ka pas parë njëherë e ka marrë një telefon të gjyshes të cilin e ka shit në pazar dhe me ato parë i kanë thënë me shkuar me ble bari të M.K. dhe me atë bari kanë mbështjell tri cigare dhe një ia kanë dhënë atij. Në nëntor të vitit 2012 e kanë shti me marrë parë nga prindit e tij, ndërsa prej frikës se do ti kallëzojnë prindit ka qenë i detyruar të bëjë si thonë ata. Pasi që ka marrë parë në vlerë prej 3€, A.H. ia ka jepur 2€ ka shkuar tek një person afër sallës së sporteve të G.M. me nofkën "...". I kanë thënë t'i thotë se është shok i S.F. e A.H., pasi që ka blerë një paketim e kanë mbështjell nga një cigare me këtë barë dhe e kanë përdorur. Asnjëherë nuk ka muajt me përfunduar cigaren. Faktin se të akuzuarit ishin se bashku me të dëmtuarin në kafenenë "NN", nuk e mohojnë dëshmitari V.S. ani pse ky dëshmitar pohon se i dëmtuari ka përdorur cigare nga pakoja e tij. Të akuzuarit e mohojnë kryerjen e kësaj veprë penale. I akuzuari A.H. në polici pranon që me G.R. ka qëndruar dy herë, se G.R. së bashku me S.F. ka shkuar tek shtëpia e tij. E ka lejuar në shtëpi vetëm e vetëm që ta pinë drogën që e ka pas me veti(G.R.), ngase nuk ka pas parë me ble drogë dhe e ka shfrytëzuar rastin që ta pijë drogën e tyre. Ka pohuar se janë incizuar me telefon por këtë e ka bërë G.R. pasi që ju ka dukur interesant. Kurse, i akuzuari S.F. ka theksuar se me G.R. ka pas kontakte rreth shitblerjes së drogës por nuk i ka dhënë drogë kundër dëshirës së tij. Në hetime ka theksuar se pasi që është njoftuar me të dëmtuarin, ai e ka takuar të dëmtuarin një muaj e gjysmë para se të arrestohej tek lumi "Sitnica", në Mitrovicë, i cili ka qenë me disa shokë të tij dhe të njëjtin e ka parë me një cigare "Joint", në dorë, se pas kësaj G.R. ka shkuar tek ai në bilardo e ka lutur t'ia shesë një kasetefon, pastaj ka shkuar dhe i ka kërkuar bari, në shqyrtimin gjyqësor ky i akuzuar është mbrojt në heshtje.

Duke pas parasysh dëshminë e të dëmtuarit të mitur, faktin se të akuzuarit në mbrojtjen e tyre nuk e vejnë në dyshim dëshminë e tij, madje ata i pohojnë disa fakte të theksuara nga i dëmtuari, kjo Gjykatë vlerëson se me pa mëdyshje është vërtetuar se të akuzuarit me dashje e kanë intoksikuar me substanca narkotike të dëmtuarin me qëllim që tek ai të krijohen shprehje të varura nga këto materiale të rrezikshme. Ndërsa, bazuar në këtë gjendje të fakteve kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal në

favor të të akuzuarve kur ajo i ka liruar të akuzuarit nga akuza për këtë vepër penale, me arsyetim se kjo vepër penale nuk është paraparë me Ligjin penal i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale ashtu siç me të drejtë pretendon Prokurori në ankesë. Kjo për arsye se kjo vepër penale është paraparë me Kodin Penal i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale, madje si forme e kualifikuar e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshme dhe substancave psikotropike (neni 229 par.4 pika 9 e KPK), ndërsa Kodi penal i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013 këtë vepër penale e parasheh si vepër penale të veçantë, për të cilën parasheh dënim shumë me të favorshëm prej 1 deri në 5 vjet burgim, për dallim nga Kodi i vjetër me të cilin parashihej dënimi me burgim prej 3 deri në 15 vjet. Për këtë arsye kjo Gjykatë duke e miratuar ankesën e Prokurorit e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë në këtë pjesë dhe të akuzuarit i shpalli fajtor për veprën penale e cila ju është venë në barrë me akuzë.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, kjo Gjykatë ndaj të akuzuarve i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante për matjen e dënimit, dhe si rrethana lehtësuese u mori se më parë nuk ka qenë të gjykuar, janë të moshës së re, i akuzuari A.H. ka gjendje të varfër ekonomike, ndërsa, përkundër asaj se nga shkresat e lëndës del se të akuzuarit dyshohen edhe për vepra tjera penale dhe për disa nga këto vepra penale procedura është në hetime apo është ngritë akuzë, meqë ende nuk janë përfunduar me aktgjykim gjykues të formës së prere, kjo Gjykatë nuk e vlerësoi një fakt të tillë si rrethanë renduese, ndërsa, në praninë e rrethanave lehtësuese të akuzuarit secilin i gjykoj me nga 1(një) vit burgim, me bindje se me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit si ndaj të akuzuarve dhe si preventivë me ndikim në të tjerët që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

## **II. vlerësimi i gjykatës përkitazi me pjesën dënuese për të akuzuarit A.H. e S.F.**

Duke e shqyrtuara aktgjykimin e kundërshtuar në këtë pjesë me të drejtë pretendohet në ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve se konkludimet e Gjykatës janë të gabuara dhe se në rastin konkret është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarve.

Siç del nga shkresat e lëndës të akuzuarit A.H. e S.F. me aktgjykimin e kundërshtuar janë shpallë fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, parashikuar me nenin 229 par.2 të KPK. Në këtë pjesë të çështjes bazuar në dëshminë e të dëmtuarit G.R. dhe vet mbrojtjet e të akuzuarve nuk është kontestuese se të akuzuarit A.H. dhe S.F. gjatë muajit shtator të vitit 2012 me paratë e të dëmtuarit kanë blerë substanca narkotike në sasi të vogla të cilat i kanë mbështjell në cigare të cilat i kanë konsumuar se bashku me të dëmtuarin.

Kontestuese është fakti se a qëndrojnë në veprimet e të akuzuarve elementet e veprës penale për të cilën ata janë shpallë fajtor?

Duke e vlerësuar aktgjykimin e kundërshtuar, pretendimet në ankesa, dhe provat e administruara në këtë çështje kjo Gjykatë gjen se në veprimet e të akuzuarve të përshkuara në dispozitivin nën pikën II të aktgjykimin nuk përmbahen elementet e veprës penale nga neni 229 par. 2 të KPK, siç gabimisht ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë. Në përshkrimin faktik të veprës në dispozitiv të aktgjykimin nder të tjera thuhet “se në muajin shtator të

vitit 2012, në afërsi të objektit ku gjendet TMK në Mitrovicë pa autorizim janë furnizuar me substanca narkotike, ashtu që pasi që takohen me të dëmtuarin G.R. ia marrin 5€, i akuzuari S.F. blejnë një qesë me substancë narkotike marihuan nga M.K. të cilin e mbështjellin në tri cigare me marihuan një i japin të dëmtuarit dhe nga një e marrin për vetë, kurse ka mesi i muajit shtator të vitit 2012 nga i dëmtuari marrin 1 e 50cent, dhe i akuzuari S.F. me këto para blejnë narkotikë nga i akuzuari M.K. me të cilin mbështjellin një cigare Joint, të cilën e kanë konsumuar të dy të akuzuarit të cilën ia shpërndajnë edhe të dëmtuarit G.R.. Sipas dispozitës së nenit 229 par. 2 të KPK parashihet se e kryen këtë veprë penale kushdo që pa autorizim shpërndanë, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme. Mirëpo, duke pas parasysh dëshminë e të dëmtuarit se këto veprime ai i ka ndërmarrë pa dëshirën e tij, të akuzuarit e shfrytëzuan atë e intoksinuan atë me qëllim të krijimit të shprehive të varësisë dhe që të blejnë drogë për përdorim të vetin personal kjo Gjykatë gjen në veprimet e tyre nuk përmbushen elementet e veprës penale, nga par. 2 i nenit 229 të KPPK siç gabimisht ka vlerësuar dhe gjykuar gjykata e shkallës së parë. Prandaj, Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin në këtë drejtim si në pikën II dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i liruar të akuzuarit nga akuza për këtë veprë penale.

### **III. Vlerësimet e gjykatës për pjesën gjyquese nën pikë III të dispozitivit të aktgjykitimit përkitazi me të akuzuarit G.M. dhe M.K..**

#### **1. Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.**

Mbrojtësi i të akuzuarit G.M. përkitazi me këtë bazë ankimore thekson se aktgjykimin i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.2 të KPK, ngase sipas ankesës gjykata në arsyetimin e aktgjykitimit nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare përkitazi me përgjegjësin penale të të akuzuarit dhe ekzistimin e veprës penale, pra, aludohet në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPP, mirëpo, në këtë drejtim e konteston gjendjen faktike, ngase e konteston deklarata e të dëmtuarit dhe konkludimin e gjykatës përkitazi me fajësinë e të mbrojturit të tij.. Mbrojtësi i të akuzuarit M.K. në këtë drejtim pretendon se aktgjykimin i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 të KPP, pasi që dispozitivi i aktgjykitimit sa i përket të mbrojturit të tij është i paqartë, në kundërshtim me provat e administruara, në arsyetim nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare gjykata vetëm ka përshkruar në mënyrë kronologjike provat e administruara, dëshmitë e dëshmitarëve, provat materiale, mbrojtjet e të akuzuarve, mirëpo, nuk i ka vlerësuar ato, nuk ka dhënë arsye se cilës provë ia fali besimin e cilës jo. Në fakt pretendimet e këtij mbrojtësi në këtë drejtim me shumë i referohen gjendjes faktike ngase kontestohen konkludimet e gjykatës dhe provat e administruara.

Edhe pse përkitazi me këtë bazë ankimore mbrojtësit e të pandehurve nuk kanë dhënë arsye të qarta se në çka konsistojnë këto shkelje, kurse arsyet e dhëna me tepër i referohen gjendjes së fakteve kjo Gjykatë e shqyrtoi aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me këto pretendime ankimore edhe konform nenit 394 të KPP, dhe konstatoi se ai nuk



përmban shkelje esenciale të pretenduara në ankesa e as shkelje të tjera të cilat kjo Gjykatë në instancë të dytë i shqyrton detyrimisht, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Aktgjykimi i kundërshtuar respektivisht dispozitivi i tij në këtë pjesë përkitazi me këta të akuzuar është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura dhe të drejta mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridiko-penale, ato kanë mbështetje në prova të administruara dhe janë arsyetuar drejt dhe plotësisht në pajtim me nenin 370 par.7 të KPP, kështu që arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë për qëndrimin dhe vlerësimin e saj përkitazi me provat e administruara veçanërisht dëshminë e të dëmtuarit dhe mbrojtjet e të akuzuarve si të drejta dhe të logjikshme i aprovon edhe kjo Gjykatë, e meqë vlerësimi i provave bie në kuadër të gjendjes faktike në këtë drejtim do të flitet në vijim.

## **2. Pretendimet përkitazi me gjendjen faktike dhe shkeljen e ligjit penal**

Përkitazi me gjendjen faktike në ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve G.M. e M.K. kontestohet konkludimi i gjykatës në bazë të provave të administruara përkitazi me fajësinë e tyre veçanërisht kontestohet dëshmia e të dëmtuarit G.R., dëshminë e të cilit mbrojtësit e konsiderojnë jo reale dhe labile. Kështu, mbrojtësi i të akuzuarit M.K. në këtë drejtim thekson se gjykata nuk e ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit M.K. i cili në kohën e kryerjes së veprave penale nuk gjendej fare në vendin e ngjarjes as në shoqëri me të akuzuarin S.F. dhe të dëmtuarin G.R., dhe mbrojtjen e tij se ai është përdorues i rregullt i marihuanës dhe se narkotikët, blurësi dhe mjetet tjera të sekuestruara në shtëpinë e tij kanë qenë të dedikuara për nevojat e tij personale. Përveç kësaj, sipas këtij mbrojtësi ekspertiza laboratorike mund të shërbej si provë përkitazi me faktin se a kemi të bëjmë me substanca narkotike të llojit të caktuar, por nuk mund të vlerësohet si provë valide se i akuzuari e ka kryer veprën. Ndërsa, meqë gjykata nuk e ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike sipas mbrojtësve ka shkelur edhe ligjin penal në dëm të të akuzuarve. Sa i përket shkeljes së ligjit penal mbrojtësi i të akuzuarit M.K. në këtë drejtim shton se Ligji penal në dëm të të mbrojturit të tij është shkelur edhe për faktin se në rastin konkret nuk mund të behet fjalë për veprë penale në vazhdim ngase veprimet e para inkriminuese i përkasin periudhës shtator –nëntor 2012 kur ishte në fuqi Kodi i vjetër penal, kurse pjesa e dytë periudhës së 19.02.2013, kur ishte në fuqi Kodi i Ri Penal dhe se në rastin konkret vjen në shprehje aplikimi i institucionit juridik të bashkimit real. Pastaj, sipas këtij mbrojtësi meqë nuk është vërtetuar fakti se i mbrojturi i tij ka shitur substanca narkotike apo ka ofruar për shitje substanca narkotike në veprimet e tij mund të qëndrojnë elementet e veprës penale nga neni 275 par.1 të KPRK

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara. Kështu, dëshmitari G.R. në dëshminë e tij ndër të tjera ka deklaruar se muajin nëntor të vitit 2012 S.F. dhe A.H. e kanë shti me marrë pare nga prindërit, pasi që kishte marrë 3€ dhe S.F. ia kishte dhënë edhe 2€, ka shku tek një person afër sallës së Sporteve të G.M. me nofkën "...", dhe i kishte thënë se është shoku i S.F. dhe A.H. ashtu siç e kishin udhëzuar ata. G.M. ia kishte dhënë një paketim me substanca narkotike, dhe nga G.M. kishte blerë vetëm një herë marihuan, dhe një herë i kishte dhënë falas. Po ashtu ka deklaruar se S.F. i ka thënë se barin e merr nga një person i quajtur M.K. me pseudonimin

“...”, dhe njëherë kishte blerë nga ky person sipas sugjerimeve të A.H. dhe S.F.. Pasi që i ka treguar se është shok i tyre ai e kishte dërguar të automjeti i tij “Alfa Romeo”- ngjyrë e kuqe dhe pasi që ia kishte dhënë 5€ kishte marrë një paketim. Në shqyrtimin gjyqësor i ka identifikuar që të dy të akuzuarit si personat nga të cilët ka blerë drogë. Faktin se ky dëshmitar është takuar me të akuzuarin G.M. nuk e ka mohuar as vet ky i akuzuar, ani pse mbrohet se ai nuk i ka shitur drogë, por thekson se është takuar me G.R. herët në mëngjes tek lokali i tij dhe pasi që vet G.R. i ka ofruar drogë ka pirë se bashku me të. Edhe dëshmitari V.S. në dëshminë e tij të dhënë në polici ka deklaruar se “e ka parë G.R.in kur ka shkuar me ... (S.F.) me marrë drogë”. Në shtëpinë të akuzuarit M.K. gjatë kontrollit të shtëpisë del se janë gjetur dhe konfiskuar një qesë e najlonit e mbushur me substancë narkotike, në sasi prej 6.9 gr., një bluarës, dy qese plasmasi të zbrazura, një qesë najloni me sasi narkotiku me peshë prej 26.08.gram dhe 17 paketime në qesë plasmasi me sasi të narkotikut. Sipas ekspertizës laboratorike sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike këto dëshmi përmbajnë marihuan që përmban tetrahidrokanabinol(THC), pesha neto e përgjithshme e përafërt 53.72 gr.

Duke pas parasysh këtë gjendje të çështjes kjo Gjykatë vlerëson se është për t'i besuar dëshmisë së dëshmitarit G.R., ngase ai në mënyrë të qartë përshkruan rastin kur ai vet kishte blerë drogë nga ta, madje, nga i akuzuari G.M. thekson se ka blerë vetëm një herë, dhe njëherë i ka dhënë falas, prandaj pretendimet e mbrojtësve se deklarata e këtij dëshmitari nuk është bindëse nuk janë të bazuara. Pretendimi ankimore i mbrojtësit të të akuzuarit M.K. se sasia e gjetur me narkotik tek i mbrojturi i tij ka qenë e dedikuar për nevoja personale, ngase i akuzuari është përdorues i substancave narkotike nuk mund të pranohet si i tillë. Meqë, me rastin e kontrollimit të shtëpisë se të akuzuarit sasia e narkotikut-marihuanës është gjetur në qesë plasmasi dhe najloni dhe 17 paketime, dhe edhe një bluarës – të cilin vet i akuzuari ka deklaruar se e ka përdor për bluarjen e marihuanës, ndërsa, nga dëshmia e të dëshmitarit rezulton se atij i ka shitur një paketim sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është jo logjike të pretendohet se i akuzuari e ka siguruar këtë sasi për konsumim personal dhe as që mund të pretendohet se në veprimet e tij qëndrojnë elementet e veprës penale, nga neni 275 të KPRK. Edhe pretendimet ankimore të mbrojtësit të këtij të akuzuari se në rastin konkret nuk mund të behet fjalë për vepër penale në vazhdim janë të pabazuara. Duke pas parasysh faktin se veprimet inkriminuese të para i takojnë periudhës shtator-nëntor 2012, ndërsa, veprimet e dyta janë ndërmarrë më 19.02.2013 kjo Gjykatë duke pas periudhën kohore të ndërmarrjes së veprimeve vlerëson se pabazë pretendohet se nuk mund të behet fjalë për vepër penale në vazhdimësi. Ndërsa, meqë veprimet e fundit janë ndërmarrë në kohën kur ishte në fuqi Kodi i Ri Penal me të drejtë vepra është cilësuar si një vepër penale në vazhdimësi sipas Kodit të ri penal.

Prandaj, kjo Gjykatë i vlerëson si të pabazuara pretendimet e mbrojtjes se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar gjendjen e fakteve dhe nuk e ka zbatuar drejt ligjin penal.

### **3. Pretendimet ankimore sa i përket vendimit për dënim**

Duke e vlerësuar aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me këta të akuzuar sa i përket vendimit për dënimin, Gjykata e Apelit gjen se ankesat e mbrojtësve për një dënim më të

butë janë të bazuara. Sipas kësaj Gjykate rrethana se këto vepra penale kanë marrë përmasa të mëdha dhe janë në rritje e sipër nuk mund të vlerësohet si rrethanë e posaçme rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit siç ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, dhe me të drejtë tërheq vërejtjen mbrojtësi i të akuzuarit M.K. në ankesë. Duke pasur parasysh këtë, dhe të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat i ka konstatuar dhe drejt vlerësuar gjykata e shkallës si moshën e re të të akuzuarve, më parë nuk kanë qenë të gjykuar, sjelljen korrekte në gjykatë, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret edhe me një dënim më të butë nga ai i përcaktuar nga gjykata e shkallës së parë për këto vepra penale do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitën përkatëse të KPRPK.

**IV.** Aktgjykimi në pjesën liruese për të akuzuarit A.H. e S.F. përkitazi me veprën penale nga neni 229 par.2 lidhur me nenin 26 të KPK nuk është kundërshtuar me ankesë nga Prokurori, prandaj në këtë pjesë aktgjykimi ka ngel i pashqyrtuar.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 403 e 402 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË**  
PAKR.nr.476/2013, datë 27 Maj 2014

Procesmbajtësi,  
Eroll Gashi

Kryetari i kolegjit,  
1.Driton Muharremi

Anëtarët e kolegjit:

2. Mejreme Memaj

3. Shqipe Qerimi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi nën piken I të dispozitivit është e lejuar ankesa, Gjykatës Supreme të Kosovës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nëpërmjet gjykatës së shkallës së parë.